



UNIVERSITETI I PRIZRENIT

UNIVERSITY OF PRIZREN

**„Ukshin Hoti“
Rektorati**

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref.

Prizren, më 15. 04. 2015

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më datën 15.04.2015, mori vendim që të shpall:

K O N K U R S

Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2014/2015

I

Bursa universitare ndahen për studentët e studimeve themelore (bachelor).

Për fitimin e bursës universitare studentët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- a) Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit të Prizrenit;
- b) Të jenë studentë të vitit të dytë, të tretë dhe katërt të cilët nuk kanë humbur asnjë vit akademik;
- c) Të kenë notë mesatare të studimeve më së paku 9.00 (nëntë pikë zero) e mbi.
- d) T'i kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit;
- e) Lartësia e pagesës së bursës do të përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues

II

Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

1. Certifikatën e vitit të regjistruar akademik 2014/2015, duke e cekur:
 - a) se është student i vitit të dytë, të tretë apo të katërt;
 - b) se i ka dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak në afatin e shtatorit,
 - c) notën mesatare gjatë studimeve
 - d) se nuk ka vit të përsëritur gjatë studimeve dhe
2. Certifikatën e provimeve të dhëna me datat e dhënies së provimeve.
3. Fletëparaqitja për aplikim dhe informatat shtesë merren në zyrën nr.308

Këshilli Drejtues i UPZ-së, do ta emërojë Komisionin për ndarjen e bursave prej 3 anëtarësh nga Universiteti i Prizrenit “ Ukshin Hoti”.

Lartësia e bursës do të caktohet varësisht nga buxheti i Universitetit të Prizrenit “ Ukshin Hoti” dhe numrit të studentëve që i plotësojnë kushtet për fitimin e bursës universitare.

Studentët bursistë do ta gëzojnë këtë të drejtë për vitin akademik 2014-2015.

Dokumentet e kompletuara paraqiten në zyrën nr. 308

Afati i paraqitjes zgjat prej datës 16.04.2015 e deri më 01.05.2015

Konkursi do të publikohet në tabelat e shpalljeve të UPZ-së, si dhe në ueb-faqen e Universitetit: www.uni-prizren.com